



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 08 /L-143**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 08/L-066 MBI  
NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
PËR VITIN 2022**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65, paragrafëve (1) dhe (5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 08/L-066 MBI  
NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
PËR VITIN 2022**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të ndryshojë dhe plotësojë Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

## **Neni 2** **Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij Ligji janë të detyrueshme për të gjitha organizatat buxhetore dhe njësitë përkatëse të tyre brenda fushëveprimit të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2022.

## **Neni 3** **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë kuptimet si në vijim:

1.1. **Ligji bazik** – nënkupton Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Ligj kanë kuptimin e përcaktuar sipas Ligjit bazik.

## **Neni 4**

Në nenin 4 të ligjit bazik, pas paragrafit 3 shtohet paragrafi 4 si në vijim:

4. Në Organizatën Buxhetore Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, në nën programin Programi i Ringjalljes Ekonomike me kod 29300 shtohet buxheti në shumë prej njëqindpesëdhjetë milion e pesëqind mijë (150,500,000) euro, në kategorinë e shpenzimeve, Subvencioneve dhe Transfereve. Ndryshimi i shumës reflektohet në tabelat buxhetore.

## **Neni 5** **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-143**  
**23 qershor 2022**

**Glauk KONJUFCA**

---

**Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**